

VENDIM
Nr.58, datë 7.8.2009

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVË PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË BALKAN GREEN
ENERGY “SHPK ME SERI PV03K, NR.3, LËSHUAR ME VENDIM TE BORDIT TË
KOMISIONERËVE
TË ERE-S NR.20, DATË 19.12.2003**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.2, 2.3 dhe 2.5 të “licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga centralet ekzistues, me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW”, si dhe nenet 10 dhe 15 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18 pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr.21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.8.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Balkan Green Energy” sh.p.k. për ndryshimin e licencës nr.3, seria PV03K, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.20, datë 19.12.2003 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe konstatoi paraqitjen e plotë të dokumentacionit siç kërkohet nga “Rregullorja për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e licensës me numër nr.3, seri PV03K, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.20, datë 19.12.2003, të mbajtura nga shoqëria Balkan Green Energy sh.p.k.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëhere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta